



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Tiranë, më 13.11.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“ PËR BUXHETIN E VITIT 2019”

Hyrje

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në disa seanca të mbledhjeve të tij të datave 5,7,12,13 nëntor 2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2019”. Kjo nismë është propozim i Këshillit të Ministrave. Relatorë të projektligjit janë: znj.Milva Ekonomi, znj. Vilma Bello dhe zoti Ismet Beqiraj.

Në mbledhjet e Komisionit, gjatë diskutimit në parim, për të paraqitur dhe mbrojtur projektligjin, si dhe për të dhënë shpjegime ishin të pranishëm znj.Lindita Nikolla, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; znj.Mirela Kumbaro, Ministre e Kulturës, znj.Dajna Sorensen, Zv/Ministre e Financave dhe Ekonomisë, si dhe ekspertë të ministrive përkatëse. Gjithashtu, në mbledhje ishin të pranishëm dhe institucionet e pavarura.

I.BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 81-83, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 80 të Rregullores së Kuvendit.

Diskutimi në parim i projektligjit u realizua nga deputetët e shumicës, pasi opozita nuk mori pjesë.

II.QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

2.1. Qëllimi i projektligjit:

Sipas relacionit shoqërues qëllimi i projektligjit “Për Buxhetin e Vitit 2019” është të mbështesë konsolidimin e mëtejshëm të reformave të ndërmarra, që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit dhe procesin e integritimit në Bashkimin Europian.

Projektbuxheti i Vitit 2019 dhe ai afatmesëm bazohen në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist. Politika fiskale ka për qëllim konsolidimin fiskal, për të vijuar **trajktoren rënese të raportit të borxhit publik ndaj PBB** dhe realizuar një rritje të qëndrueshme ekonomike mbi nivelin 4%. Objektiv mjaft i rëndësishëm i këtij buxheti është synimi për rritjen e **investimeve publike prej 5% e PBB**.

2.2. Risitë e projektligjit

Rritja ekonomike parashikohet të vijojë të forcohet dhe të arrijë nivelin 4.3% në vitin 2019. Norma mesatare e papunësisë parashikohet të bjerë në 12% në 2019, dhe pritet të gjenerohen mbi 30 mijë vende të reja pune. Projektbuxheti 2019 planifikon më shumë burime, si rezultat i politikave fiskale, të cilat do të vazhdojnë të bazohen në taksimin e ndershëm dhe në nxitjen e investimeve private strategjike në sektorët prioritarë. Ky program bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi. Projektbuxheti i vitit 2019 synon të shpërndajë në mënyrë më të drejtë barrën fiskale, duke ulur ngarkesën për grupe, kategori dhe sektorë të caktuar.

Shpenzimet Buxhetore për periudhën afatmesme do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike, duke u përqendruar në financimin e projekteve të rëndësishme strategjike. Shpenzimet e planifikuara synojnë finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe, veçanërisht për këtë vit, mbështetjen e sektorit të bujqësisë. Rijetëzimi rural do të jetë fokusi kryesor i mbështetjes së qeverisë për zhvillimin rajonal në këtë mandat katërvjeçar. Për këtë qëllim, programi *100 Fshatrat* do të synojë të koordinojë ndërhyrjet zhvillimore në hapësirën rurale të 100 fshatrave, sipas qasjes ndërsektoriale dhe me shumë aktorë.

Projektbuxheti 2019 financon politika të reja për: (i) Rritjen e pagave në sektorët e shëndetësisë, arsimit parauniversitar, mbrojtjes dhe sistemit penitenciar me një rritje prej 7%. Numri i përfituesve është 64 865 punonjës, me një kosto prej 3 miliardë lekë në vit. Vetëm në arsim përfitojnë 35,783 staf mësimor me një fond vjetor prej rreth 1.4 miliardë lekë;

Lehtësimin e barrës fiskale nga e cila përfitojnë mbi 15 mijë punëmarrës nga ulja e normës së tatimit mbi pagat e nivelit të mesëm.

Nga përjashtimet e parashikuara në Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, lehtësohet veprimtaria e qindra operatorëve ekonomikë në industrinë e fasonit, atë farmaceutike, makinerive bujqësore.

Shpërblimin për çdo lindje me synim përmirësimin e treguesit demografik të moshës mesatare të popullsisë, nga e cila parashikohet të përfitojnë rreth 30 mijë familje.

Buxheti i MASR 2019, krahasuar me planin e buxhetit të rishikuar të vitit 2018, ka pësuar rritje me 792 milion lekë ose 2,07% më shumë se viti 2018. Rritja reflektohet konkretisht në: shpenzimet korrente, të cilat janë shtuar në total me 613 milion lekë; shpenzimet kapitale/investimet janë shtuar në total me 180 milionë lekë më shumë sesa buxheti i rishikuar 2018 ose 5% më shumë krahasuar me një vit më parë.

Fondet e buxhetit të shtetit për vitin 2019 për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në raport me Totalin e Shpenzimeve Buxhetore arrijnë në 7.5 % dhe në raport me Produktin e Brendshëm Bruto arrijnë në 2.2 %.

Fondet për “Sektorin e Arsimit” të parashikuara për vitin 2019, si pjesë e buxhetit për arsimin, parashikohet të arrijnë në total në vlerën e 57.8 miliardë lekë. Krahasuar me Totalin e shpenzimeve publike, fondet për sektorin e arsimit parashikohet të arrijnë në 11% . Krahasuar me Produktin e Brendshëm Bruto, fondet për sektorin e arsimit parashikohet të arrijnë në 3.3% e PBB-së.

Arsimi Parauniversitar (arsimi parashkollor, arsimi bazë dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm)

Fondet totale janë 29,7 miliardë lekë, nga të cilat personeli zë 25.1 miliardë lekë dhe investimet kapitale janë 2.782 miliardë lekë. Ky buxhet synon të reduktojë raportin nxënës për klasë, 2019-2021, të ulë treguesit mbi braktisjen shkollore, të përmirësojë nivelin e arritjeve në arsimin parauniversitar, si dhe të përmirësojë rezultatit dhe renditjen e Shqipërisë në vlerësimin ndërkombëtar PISA dhe TIMS. Gjithashtu, buxheti synon që brenda vitit 2019, të realizojë edhe përfshirjen e klasës V dhe i gjithë sistemi arsimor parauniversitar të punojë me kurrikulat dhe tekstet e reja, të njëjta me kurrikulat analoge të BE-së.

Në vitin 2019 do të rriten me 20% shkollat qendër komunitare, duke e çuar në total numrin e shkollave SHQK në 325 të tilla, çka nënkupton se për 50 shkolla të reja, nevojiten 500 orë mësimore, të cilat do të zhvillohen jashtë procesit mësimor. Buxheti do të garantojë ShPS; në shkollat e arsimit të mesëm të lartë është ofruar sipas normës një psikolog dhe një punonjës social për çdo 2,800-3,500 nxënës, si dhe Shërbimin e Sigurisë në Shkolla, i cili do të sigurohet nga shërbimi i sigurisë në shkolla, ku janë parashikuar 150 punonjës sigurie për shkollat e arsimit të mesëm të përgjithshëm.

Buxheti parashikon, gjithashtu, të ndihmojë nxënësit me nevoja të veçanta, duke realizuar shndërrimin deri në vitin 2019 të Institutit të Nxënësve që nuk dëgjojnë në Qendër Burimore. Brenda 2 viteve të ardhshme do të rriten treguesit për regjistrimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë të grupmoshës 6-16 vjeç në arsimin 9-vjeçar në masën 10-15%. Do të rriten me 10% nxënësit me AK, shoqëruar me dyfishimin e numrit të mësuesve ndihmës për nxënësit me AK, nga 310 mësues që janë aktualisht.

Produktet/ aktivitetet/ shërbimet më të domosdoshme që janë parashikuar të mbulohen me buxhetin 2019 në arsimin parauniversitar:

- Në përputhje me VKM nr.692, datë 29.7.2015, MASR do të mbulojë shpenzimet në vlerën e 650 milionë lekëve për transportin e 29-30 mijë nxënësve që kanë vendbanimin mbi 2 km nga shkolla, si dhe transportin e 12 mijë mësuesve që punojnë mbi 5 km largësi nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë;
- shpenzimet e parashikuara në vlerën e 650 milionë lekëve në vit për blerjen e teksteve shkollore për rreth 190 mijë nxënës të arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevojë, si dhe për pilotimin e skemës së sigurimit të teksteve falas për nxënësit e klasës I-V, duke përfshirë në vitin 2019 edhe nxënësit e klasës V;
- 18-20 milionë lekë në vit do të shkojnë për kuotën ushqimore të nxënësve me nevoja të veçanta për rreth 1000-1400 nxënës të arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevojë;
- 38-40 milionë lekë në vit do të shkojnë për veprimtarinë e Institutit të Zhvillimit të Arsimit dhe Inspektoriatit Shtetëror të Arsimit. Ristrukturimi i tyre në një institucion të vetëm do të synojë rritjen e cilësisë së shërbimit arsimor, zhvillim të kurrikulave, trajnim të punonjësve-mësuesve në AP, monitorim, inspektim në standarde europiane;
- 50 milionë lekë në vit shkojnë për shpenzimet mbi veprimtarinë e Maturës Shtetërore, provimet e shtetit, si dhe testime kombëtare e ndërkombëtare;
- 50 – 60 milionë lekë në vit shkojnë për shpenzimet për trajnimin çdo vit të 10-15% të punonjësve mësimorë të arsimit parauniversitar;
- 50-60 milionë lekë në vit shkojnë për blerje materialesh didaktike mësimore të arsimit parauniversitar;
- si dhe 50-60 milionë lekë në vit shkojnë për blerje shërbim interneti në arsimin parauniversitar.

Buxheti për arsimin profesional. Investimi në AFP është ndër investimet më eficiente me impakt të sigurtë dhe të drejtpërdrejtë në zhvillimin e biznesit dhe rritjen ekonomike të vendit, pasi i përgjigjet mungesave për punonjës të kualifikuar, nxit produktivitetin dhe fitimet e kompanive, rigjallëron sektorët ekonomikë në rënie, për shkak të mungesave në aftësi dhe nxit investime huaja në vend.

Alokimet e buxhetit të shtetit për vitin 2018 mbështetën rindërtimin dhe ndërtimin e bazave të reja të prodhimit në 9 shkolla profesionale, si dhe blerjen e pajisjeve dhe mobiljeve për shkollat e arsimit profesional. Fondet buxhetore për vitin 2019 për arsimin profesional janë 3,3 miliardë lekë, me një rritje prej 321.5 milion lekë në krahasim me vitin 2018. Fondet e planifikuara në buxhetin e vitit 2019 për arsimin e mesëm profesional janë rritur me 10.7% më shumë se në 2018-ën. Përqindja që zë buxheti i arsimit profesional në shpenzimet totale për sektorin e arsimit është 6%. Buxheti i arsimit në total përbën 3.3% GDP, nga ku shpenzimet për arsimin profesional janë 0.19%. Në shpenzimet totale të buxhetit 2019 arsimiti profesional zë 0.6%.

Buxheti 2019 për arsimin e lartë ka shënuar një rritje prej 3.7% ose 290 milion lekë më shumë se buxheti 2018, rritje e cila është orientuar kryesisht në shpenzimet kapitale (me afro 50% më shumë se buxheti 2018).

Gjithashtu, edhe buxheti për kërkimin shkencor në vitin 2019 ka një rritje me 29% ose 101 milionë lekë më shumë krahasuar me vitin 2018, e cila destinohet kryesisht për projektet kërkimore - shkencore të IAL-ve. Fondet nga buxheti i shtetit shpërndahen në formë granti për politika të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë, si dhe granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese, sipas kriterëve : (i) granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë parashikohet jo më pak se 10% e totalit të grantit vjetor; (ii) granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese parashikohet jo më pak se 5% e totalit të grantit vjetor;

Fondi për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike shpërndahet mbi bazën e renditjes së institucioneve publike të arsimit të lartë, të kryer nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Ky fond detajohet nga Bordet e Administrimit të vetë IAL-ve.

Aktivitetet kryesore që mbulohen nga buxheti 2019 për Arsimin e lartë dhe Kërkimin shkencor ndahen në fonde: (i) fonde për mbështetjen e studentëve, për të mbuluar shpenzimet për bursat e studentëve nga shtresat sociale në nevojë, si dhe studentëve ekselentë në IAL-të publike në shumën e parashikuar prej 400 milionë lekësh në vit; (ii) fondi për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike (6,8 miliardë lek), i cili detajohet nga Bordet e Administrimit të vetë IAL-ve; (iii) fonde për të mbuluar shpenzimet e studentëve për akomodimin e tyre në tetë “Shoqëritë e Trajtimit të Studentëve në Tiranë dhe në rrethe”, ku parashikohet të akomodohen rreth 12 -14 mijë studentë, janë parashikuar 350 milion lekë në vit; (iv) fonde për të mbuluar shpenzimet për bursat e studentëve ekselencë, që ndjekin studimet në 15 universitetet më të mira, referuar renditjes së “Times Higher Education”, si dhe punonjësve të administratës publike, të cilët përfitojnë trajnime/kualifikime apo studime të ciklit të dytë dhe tretë në 300 universitetet më të mira të botës, janë parashikuar çdo vit 180 milion lekë; (v) mbështetje financiare për studentët praktikantë dhe personelin akademik për të studiuar jashtë vendit, mbështetje për sportin dhe aktivitetet rinore, duke e bërë Shqipërinë tashmë pjesëmarrëse me titull të plotë në programin “Erasmus+”, që synon të nxisë modernizimin e sistemeve arsimore, si dhe (vi) mbështetja financiare për pjesëmarrjen në marrëveshjen kuadër “Horizon 2020”, Programi i BE-së për Kërkim dhe Inovacion, si dhe programi “Eurostudent” janë parashikuar nga 100 -140 milionë lekë në vit.

Buxheti për MK 2019. Projektbuxheti i vitit 2019 krahasuar me projektbuxhetin e vitit 2018 ka një rritje prej 156 milionë lekë, nga të cilat 55 milionë lekë në investime dhe në korente 101 milion lekë.

Rritje më e madhe është në programin e Art & Kulturë. Në fushën e trashëgimisë kulturore prioritet për shpenzimet korrente do të jenë mirëmbajtja e monumenteve të kulturës sipas listës së emergjencës të gjendjes fizike të tyre, parqeve arkeologjike dhe muzeve kombëtare, si dhe për të përballuar detyrimet për ruajtjen e objekteve apo çdo detyrim tjetër që lidhet me to. Përmirësimi gjithnjë e në rritje i të ardhurave nga turizmi kulturor në fushën e trashëgimisë kulturore ka rritur ndjeshëm numrin e vizitorëve vendas e të huaj.

Në fushën e artit dhe kulturës në prioritetet e vitit 2019-2021 vëmendje e posaçme do i kushtohet rikualifikimit dhe rikonceptimit të institucioneve qendrore të artit dhe kulturës. Vijimi i një reforme tashmë të nisur në institucionet e artit përmes programit kombëtar “Edukimi përmes Kulturës”, do të rrisë efikasitetin e edukimit përmes librit, veprimtarive të artit skenik, përfshirë dhe Teatrin Eksperimental, nxitjes së artistëve të rinj, organizimit të ekspozitave kombëtare dhe ndërkombëtare të arteve pamore, kinematografisë etj.. Edukimi masiv me art e kulturë do të synojë ndërhyrjen në kurrikulat shkollore, nga njëra anë, si dhe përfshirjen, nga ana tjetër, në çdo institucion arti të linjës pedagogjike dhe edukative. Do të vihet në zbatim Strategjia Kombëtare e Kulturës “Shqipëria 2018-2025”, përmes së cilës synohet që arti dhe kultura të bëhen tërheqës për biznesin dhe financuesit e tjerë jo publikë, përmes lehtësirave ligjore dhe fiskale.

IV. KONSULTIMI PUBLIK I PROJEKTLIGJIT

Komisioni mbështetur në nenin 36, pika 1, dhe nenin 80, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, në kuadër të gjithëpërfshirjes, transparencës dhe konsultimit publik, ka realizuar seanca dëgjimore me aktorë të interesit, si: Akademinë e Shkencave; Akademinë e Studimeve Albanologjike, RTSH-në; QKK-në, universitetet publike, si në Tiranë dhe në rrethe, ATSH-në, sindikatat e arsimit.

Akademia e Shkencave ka vlerësuar mbështetjen nga qeveria për buxhetin e saj edhe për vitin 2019. Ajo kërkoi në seancën dëgjimore të shikohet me përparësi mundësia për shtetëzimin e godinës ku kryen aktivitetin Akademia e Shkencave, e cila përfshihet në listën e monumenteve të kulturës, kategoria e parë, në Qendrës Historike të Tiranës, e shpallur me Urdhrin e Ministrisë së Kulturës, nr.67 datë 17.03.2016. Në zërin investime kërkuan një shtesë prej 1 milion për sistemin elektrik të sallës së konferencave.

Akademia e Studimeve Albanologjike ka parashtruar një sërë çështjesh që lidhen me funksionimin e saj. Ata kërkuan shtesë në paga për të mbuluar veprimtarinë kërkimor për gjatë gjithë vitit, si dhe fond shtesë për botime të studimeve.

Ata kërkuan fonde për rikonstrukcionin e Muzeut Arkeologjik dhe mbulimin e disa nevojave në logjistikë të nevojshme për të kryer veprimtarinë e vet.

Për Radiotelevizionin Shqiptar, RTSH-në, në projektbuxhetin e vitit 2019, është parashikuar në total vlera 615 milionë lekë.

Bazuar në ligjin 97/2013 “ Për mediat audivizive në Republikën e Shqipërisë” , neni 113, RTSH-ja përfiton financim nga Buxheti i Shtetit në 4 programe kryesore :

1. Shërbime për shqiptarët jashtë kufijve e Shërbimi në gjuhë të huaj;
2. projekte teknike për futjen e teknologjive të reja;
3. prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare;
4. Orkestra simfonike e RTSH dhe Kinematografia.

FINANCIMI BUXHETOR RTSH	<i>Parashikimi vitit 2019 (në milionë lekë)</i>
Shërbimi për shqiptarët jashtë kufirit e Shërbimi në gjuhë të huaj	240
Prodhime filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare	65
Orkestra Simfonike e RTSH dhe Kinematografisë	60
Projekte teknike për futjen e teknologjive të reja	250
TOTALI	615

Ky total në vlerën 615 milionë lek rezulton 150 milionë lekë më pak se buxheti fillestar i akorduar për RTSH-në në vitin 2018, ndërkohë që me aktin normativ të Qeverisë në shtator 2018, u shtuan 100 milionë lekë, duke e çuar totalin e buxhetit të akorduar nga shteti në vlerën 765 milionë lekë.

Mazhoranca nxit RTSH-në për një punë gjithnjë e më efektive për përmbushjen e detyrimeve ligjore të saj, duke u shndërruar realisht në një televizion të paanshëm, rezultativ dhe gjithnjë e më shumë në rritje të shikueshmërisë së publikut.

RTSH-ja këmbëngul në kërkesën e saj për një mbështetje buxhetore të qëndrueshme dhe në vazhdimësi, duke kërkuar domosdoshmërinë e rritjes së financimit për projektet dhe veprimtaritë. Kërkesa e RTSH-së për shtesë financimi buxhetor për katër programet për vitin 2019, është në vlerën totale 540 milionë lekë.

Mazhoranca në komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, mbështet RTSH-në për kërkesat e saj, duke i vlerësuar të nevojshme, në frymë edhe të Rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së RTSH-së për vitin 2017 dhe rekomandimet e adresuara për vitin 2018, ku një ndër kërkesat e Rezolutës së Kuvendit është “Kuvendi dhe Qeveria të kenë në fokus monitorimin për zhvillimin e RTSH-së dhe të sigurojë mbështetjen e duhur financiare gjatë procesit të rinovimit teknologjik të RTSH-së”, dhe rekomandon shtesë **490 milion** nga 540 milionë lekë të kërkuara nga RTSH-ja.

Qendra Kombëtare e Kinematografisë ka kërkuar që vlerës totale të buxhetit prej 164,3 milionë lekësh, t’i shtohet fondi prej 27 milionë lekë në buxhetin e vitit 2019, shtesë fondi si më poshtëshënuar: (i) shtesë fondi për projektin “FESTIVALI I 14-të KOMBËTAR I FILMIT SHQIPTAR”, në shumën 13 milionë lekë; (ii) shtesë fondi për projektin “Mbështetje për Akademinë e Filmit dhe Multimedias “MARUBI”, institucion me status të veçantë”, në shumën 7 milionë lekë; (iii) shtesë fondi për projektin ndërrajonal Itali-Shqipëri-Mali i Zi “CIRCE”, në shumën 7 milionë lekë.

Komisioni mbështet kërkesën 13 milionë lekë për organizimin e “FESTIVALI I 14-të KOMBËTAR I FILMIT SHQIPTAR”.

Agjencia Telegrafike Shqiptare, ATSH.

Roli i ATSH-së për vitin 2018, është rritur ndjeshëm për sa i takon komunikimit me partnerët tanë jashtë, duke zgjeruar marrëdhëniet e bashkëpunimit me agjenci me reputacion. ATSH-ja kërkon për fondin e pagava në vitin 2019 të korigjohet një mospërputhje, që sipas bisedës me specialistin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, konsiderohet gabim teknik, i cili ka zbritur me 2.000.000 lekë planin e vitit 2018, në të kundërt rrezikohet funksionimi i institucionit.

Kërkohej, gjithashtu, një shtesë pagash prej 1 milion lekësh dhe një shtesë në investime prej 5 milionë lekësh.

Institucioni	Plani 000/lek	Zëri buxhetor	Kërkesa shtesë 000/lek	Miratimi i KEMIP
MARS	39,167,143		0	PO
MK	2,165,867		0	PO
AP	3,319			PO
ASH	110,000	investime	2,000	1,000
ASA	190,114		122,000	përmirësime ligjore dhe kujdes në rritje për investimet
RTSH	615,000	investime	540,000	490,000
QKK	169,120	korrente/festival	27,000	13,000
ATSH	69,000	paga/investime	6,000	5,000

Universitetet publike

Rektorët dhe zv/rektorët e universiteteve publike, pjesëmarrës në seancat dëgjimore për projekligjin e “Buxhetit të Vitit 2019”, propozuan që për vitin 2019 të shihen me përparësi dhe të konsiderohet mundësia e rritjes së buxhetit të universiteteve në tre drejtime:

1. në rritjen në drejtim të fondeve në fushën e kërkimit shkencor, në grandin e parashikuar;
 2. të rriten fondet grand në drejtim të investimeve në infrastrukturë në një masë më të madhe sesa janë parashikuar, sipas nevojave të domosdoshme që kanë parashikuar universitetet;
 3. rritjen e fondeve në drejtim të grandit për të mbuluar pagën gjithëvjetoje të pedagogëve.
- U kërkuan investime për të mbështetur një zhvillim të qëndrueshëm të universiteteve rajonale.

Sindikatat e Arsimit të Shqipërisë

Në seancat dëgjimore të organizuara nga Komisioni, sindikatat e arsimit propozuan:

- rritje të buxhetit për arsimin deri në 5% të GDP-së; shtesa prej 200 milionë lekësh, në krahasim me buxhetin e vitit 2018, është e ulët;
- të parashikohet në buxhetin e vitit 2019 rritja e pagave jo më pak se 10%; dhënia e shpërblimeve vjetore dhe periodike;
- dhënia e librave dhe fletoreve të punës falas për të gjithë nxënësit në arsimin e detyrueshëm;
- buxheti i vitit 2019 i arsimit profesional të kalojë te MASR-ja, dhe rinia dhe sporti të kalojnë në ministri të tjera;
- institucionet arsimore parashkollore dhe institucionet e arsimit parauniversitar të kenë kushtet e domosdoshme higjiëno-sanitare, bazë për punë dhe zhvillimin normal të procesit mësimor;
- të përfshihet në kurrikulën universitare dhe mbeshtetja në buxhet për krijimin dhe funksionimin e Mjekësisë së Punës. Mendojnë se fondi i planifikuar në buxhet për transportimin e nxënësve dhe mësuesve, ka qene dhe mbetet i pamjaftueshëm.

V. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, duke vlerësuar projektligjin “ Për Buxhetin e Vitit 2019” në tërë komponentët e tij, me votat e të gjithë deputetëve të mazhorancës, miratoi në parim projektligjin dhe i paraqet Raportin e tij Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

RELATORË

Vilma BELLO

Ismet BEQIRAJ

ZV/KRYETARE

RELATORE

Milva EKONOMI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

(Dekument Parlamentar)

Tiranë, më 19. 11.2018

RAPORT

PËR DISKUTIMIN NEN PËR NEN DHE NË TËRËSI TË PROJEKTLIGJIT

“ PËR BUXHETIN E VITIT 2019”

Hyrje

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e tij të datës 19 nëntor 2018, mori në shqyrtim nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2019”. Kjo nismë është propozim i Këshillit të Ministrave. *Shqyrtimi* nen për nen i projektligjit e vuri theksin sidomos për institucionet që janë në fushën e përgjegjësisë së Komisionit.

Relatorë të projektligjit janë: znj. Milva Ekonomi, znj. Vilma Bello dhe z. Ismet Beqiraj.

Në mbledhjet e Komisionit, gjatë diskutimit nen për nen ishin të pranishëm: Znj. Besa Shahini, Zv/Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, z. Florian Nurçe, përgjegjës në sektorin e Buxhetit në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar; Z.Oltjon Muzaka, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës; z. Shpëtim Shehu, Drejtor, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar; znj. Eridiana Zoto, përgjegjëse sektori në këtë drejtori në MK; z. Gentian Opre, drejtor i buxhetit në Ministrinë e Finanave dhe Ekonomisë; znj. Ina Dhaskali, përgjegjëse sektori.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 81-83, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 80 të Rregullores së Kuvendit.

Diskutimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit u realizua nga deputetët e shumicës, pasi opozita nuk mori pjesë.

II. QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

2.1 Qëllimi i projektligjit:

Sipas relacionit shoqërues, qëllimi i projektligjit “Për Buxhetin e Vitit 2019”, është të mbështesë konsolidimin e mëtejshëm të reformave të ndërmarra që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit dhe procesin e integritetit në Bashkimin Europian.

Projektbuxheti i Vitit 2019 dhe ai afatmesëm bazohen në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist. Politika fiskale ka për qëllim konsolidimin fiskal, për të vijuar **trajektoren rënëse të raportit të borxhit publik ndaj PBB** dhe realizuar një rritje të qëndrueshme ekonomike mbi nivelin 4%. Objektiv mjaft i rëndësishëm i këtij buxheti është synimi për rritjen e **investimeve publike prej 5% e PBB**.

2.2 Risitë e projektligjit

Rritja ekonomike parashikohet të vijojë të forcohet dhe të arrijë nivelin 4.3% në vitin 2019. Norma mesatare e papunësisë parashikohet të bjerë në 12% në 2019 dhe pritet të gjenerohen mbi 30 mijë vende të reja pune. Projektbuxheti 2019 planifikon më shumë burime si rezultat i politikave fiskale, të cilat do të vazhdojnë të bazohen në taksimin e ndershëm dhe në nxitjen e investimeve private strategjike në sektorët prioritarë. Ky program bazohet në përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi. Projektbuxheti i vitit 2019 synon të shpërndajë në mënyrë më të drejtë barrën fiskale, duke ulur ngarkesën për grupe, kategori dhe sektorë të caktuar.

Shpenzimet Buxhetore për periudhën afatmesme do të mbështesin një nivel të lartë investimesh publike duke u përqendruar në financimin e projekteve të rëndësishme strategjike.

Shpenzimet e planifikuara synojnë finalizimin e projekteve të rrugëve nacionale, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe veçanërisht për këtë vit mbështetjen e sektorit të bujqësisë. Rijetëzimi rural do të jetë fokusi kryesor i mbështetjes së qeverisë për zhvillimin rajonal në këtë mandat katërvjeçar. Për këtë qëllim, programi *100 Fshatrat* do të synojë të koordinojë ndërhyrjet zhvillimore në hapësirën rurale të 100 fshatrave, sipas qasjes ndërsektoriale dhe me shumë aktorë.

Projektbuxheti 2019 financon politika të reja për: (i) Rritjen e pagave në sektorët e shëndetësisë, arsimit parauniversitar, mbrojtjes dhe sistemit penitenciar me një rritje prej 7%. Numri i përfituesve është 64 865 punonjës me një kosto prej 3 miliardë lekë në vit. Vetëm në arsim përfitojnë 35,783 staf mësimor me një fond vjetor prej rreth 1.4 miliardë lekë;

Lehtësimin e barrës fiskale, nga e cila përfitojnë mbi 15 mijë punëmarrës nga ulja e normës së tatimit mbi pagat e nivelit të mesëm;

Nga përjashtimet e parashikuara në Tatimin mbi Vlerën e Shtuar lehtësohet veprimtaria e qindra operatorëve ekonomikë në industrinë e fasonit, atë farmaceutike, makinerive bujqësore.

Shpërblimin për çdo lindje me synim përmirësimin e treguesit demografik të moshës mesatare të popullsisë nga e cila parashikohet të përfitojnë rreth 30 mijë familje

Buxheti i MASR 2019, krahasuar me planin e buxhetit të rishikuar të vitit 2018, ka pësuar rritje me 792 milion lekë ose 2,07% më shumë se viti 2018. Rritja reflektohet konkretisht në: Shpenzimet korrente të cilat janë shtuar në total me 613 milion lekë; Shpenzimet kapitale/Investimet janë shtuar në total me 180 milion lekë më shumë se buxheti i rishikuar 2018 ose 5% më shumë krahasuar me një vit më parë.

Fondet e buxhetit të shtetit për vitin 2019 për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në raport me Totalin e Shpenzimeve Buxhetore arrijnë në 7.5 % dhe, në raport me Produktin e Brendshëm Bruto, arrijnë në 2.2 %.

Fondet për “Sektorin e Arsimit” të parashikuara për vitin 2019, si pjesë e buxhetit për arsimin, parashikohet të arrijnë në total në vlerën e 57.8 miliard lekë. Krahasuar me Totalin e shpenzimeve publike, fondet për sektorin e arsimit parashikohet të arrijnë në 11% . Krahasuar me Produktin e Brendshëm Bruto, fondet për sektorin e arsimit parashikohet të arrijnë në 3.3% e PBB-së.

Arsimi Parauniversitar

(arsimi parashkollor, arsimi bazë dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm)

Fondet totale janë 29,7 miliardë lekë, nga të cilat personeli zë 25.1 miliardë lekë janë shpenzime personeli/paga+sigurime shoqërore/shëndetësore dhe investimet kapitale janë 2.782 miliardë lekë janë shpenzime. Ky buxhet synon të reduktojë raportin nxënës për klasë, 2019-2021, të ulë teguesit mbi braktisjen shkollore, të përmirësojë nivelin e arritjeve në arsimin parauniversitar, si dhe të përmirësojë rezultatin dhe renditjen e Shqipërisë në vlerësimin ndërkombëtar PISA dhe TIMS. Gjithashtu, buxheti synon që brenda vitit 2019 të realizojë edhe përfshirjen e klasës V dhe të gjithë sistemi arsimor parauniversitar të punojë me kurrikulat dhe tekstet e reja, të njëjta me kurrikulat analoge të BE.

Në vitin 2019 do të rritet me 20% shkollat-qendër komunitare, duke e çuar në total numrin e shkollave SHQK, në 325 të tilla; çka nënkupton se për 50 shkolla të reja, nevojiten 500 orë mësimore, të cilat do të zhvillohen jashtë procesit mësimor. Buxheti do të garantojë ShPS, i cili, në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, është ofruar sipas normës: një psikolog dhe një punonjës social për çdo 2,800-3,500 nxënës. Si dhe Shërbimin e Sigurisë në Shkollë, i cili do të sigurohet nga shërbimi i sigurisë në shkollë, ku janë parashikuar 150 punonjës sigurie për shkollat e arsimit të mesëm të përgjithshëm.

Buxheti parashikon, gjithashtu, të ndihmojë nxënësit me nevoja të veçanta, duke realizuar shndërrimin deri në vitin 2019 të Institutit të Nxënësve që nuk dëgjojnë, në Qendër Burimore. Brenda 2 viteve të ardhshme do të rriten treguesit për regjistrimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë të grupmoshës 6-16 vjeç në arsimin 9-vjeçar në masën 10-15%. Do të rriten me 10% nxënësit me AK, shoqëruar me dyfishimin e numrit të mësuesve ndihmës për nxënësit me AK, nga 310 mësues që janë aktualisht.

Produktet/ aktivitetet/ shërbimet më të domosdoshme që janë parashikuar të mbulohen me buxhetin 2019 në arsimin parauniversitar.

- ***Në përputhje me VKM nr.692, datë 29.7.2015, MASR do të mbulojë shpenzimet në vlerën e 650 milionë lekëve për transportin e 29-30 mijë nxënësve që kanë vendbanimin mbi 2 km nga shkolla si dhe transportin e 12 mijë mësuesve që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë.***
- ***shpenzimet e parashikuara në vlerën e 650 milion lekëve në vit për blerjen e teksteve shkollore për rreth 190 mijë nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë, si dhe për pilotimin e skemës së sigurimit të teksteve falas për nxënësit e klasës I-V, duke përfshirë në vitin 2019 edhe nxënësit e klasës së V-të.***
- ***18-20 milion lekë në vit do të shkojnë për kuotën ushqimore të nxënësve me nevoja të veçanta për rreth 1000-1400 nxënës të arsimit para-universitar nga shtresat sociale në nevojë.***
- ***38-40 milion lekë në vit do të shkojnë për veprimtarinë e Institutit të Zhvillimit të Arsimit dhe Inspektoriatit shtetëror të arsimit. Ristrukturimi i tyre në një institucion të vetëm do***

të synojë rritjen e cilësisë së shërbimit arsimor, zhvillim të kurikulave, trajnim punonjësve-mësuesve në AP, monitorim, inspektim në standarde europiane.

- *50 milionë lekë në vit shkojnë për shpenzimet mbi veprimtarinë e Maturës Shtetërore, provimet e shtetit, si dhe testime kombëtare e ndërkombëtare.*
- *50 – 60 milion lekë në vit shkojnë për shpenzimet për trajnimin çdo vit të 10-15% të punonjësve mësimorë të arsimit para-universitar.*
- *50-60 milion lekë në vit shkojnë për për blerje materiale didaktike mësimore të arsimit para-universitar*
- *Si dhe 50-60 milion lekë në vit shkojnë për blerje shërbim interneti në arsimin para-universitar*

Buxheti për Arsimin Profesional

Investimi në AFP është ndër investimet më eficiente me impakt të sigurtë dhe të drejtpërdrejtë në zhvillimin e biznesit dhe rritjen ekonomike të vendit, pasi i përgjigjet mungesave për punonjës të kualifikuar, nxit produktivitetin dhe fitimet e kompanive, rigjallëron sektorët ekonomikë në rënie, për shkak të mungesave në aftësi dhe nxit investime huaja në vend.

Alokimet e buxhetit të shtetit për vitin 2018 mbështetën rindërtimin dhe ndërtimin e bazave të reja të prodhimit në 9 shkolla profesionale, si dhe blerjen e pajisjeve dhe mobiljeve për shkollat e arsimit profesional. Fondet buxhetore për vitin 2019 për arsimin profesional janë 3,3 miliard lekë, me një rritje prej 321.5 milion lekë në krahasim me vitin 2018. Fondet e planifikuara në buxhetin e vitit 2019 për arsimin e mesëm profesional janë rritur me 10.7% më shumë se në 2018-ën. Përqindja që zë buxheti i arsimit profesional në shpenzimet totale për sektorin e arsimit është 6%. Buxheti i Arsimit në total përbën 3.3% GDP, nga ku shpenzimet për Arsimin profesional janë 0.19%. Në shpenzimet totale të buxhetit 2019 i zë arsimit profesional 0.6%.

Buxheti 2019 për arsimin e lartë ka shënuar një rritje prej 3.7% ose 290 milion lekë më shumë se buxheti 2018, rritje e cila është orientuar kryesisht në shpenzimet kapitale (me afro 50% me shume se buxheti 2018).

Gjithashtu, edhe buxheti për kërkimin shkencor në vitin 2019 ka një rritje me 29% ose 101 milionë lekë më shumë, krahasuar me vitin 2018, e cila destinohet kryesisht për projektet kërkimore shkencore të IAL-ve. Fondet nga buxheti i shtetit shpërndahen në formë granti për politika të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë, si dhe granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese, sipas kriterëve : (i) granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë parashikohet jo më pak se 10% e totalit të grantit vjetor; (ii) granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese parashikohet jo më pak se 5% e totalit të grantit vjetor;

Fondi për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike shpërndahet mbi bazën e renditjes së institucioneve publike të arsimit të lartë, të kryer nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Ky fond detajohet nga Bordet e Administrimit të vetë IAL.

Aktivitetet kryesore që mbulohen nga buxheti 2019 për Arsimin e lartë dhe Kërkimin shkencor ndahen në fonde (i) Fonde për mbështetjen e studentëve, për të mbuluar shpenzimet për bursat e studentëve nga shtresat sociale në nevojë si dhe studentëve ekselentë në IAL-të publike në shumën e parashikuar prej 400 milion lekësh në vit, (ii) Fondi për mbështetjen e institucionit dhe infrastrukturës akademike (6,8 miliardë lek) i cili detajohet nga Bordet e Administrimit të vetë IAL, (iii) Fonde për të mbuluar shpenzimet e studentëve për akomodimin e tyre në tetë “Shoqëritë e Trajtimit të studentëve në Tiranë dhe në Rrethe”, ku parashikohet të akomodohet rreth 12 -14 mijë studentë, janë parashikuar 350 milion lekë në vit, (iv) Fonde për të mbuluar shpenzimet për bursat e studentëve ekselentë, që ndjekin studimet në 15 universitetet më të mira, referuar renditjes së “Times Higher Education”, si dhe punonjësve të administratës publike, të cilët përfitojnë trajnime/kualifikime apo studime të ciklit të dytë dhe tretë në 300 universitet më të mira të botës; janë parashikuar çdo vit 180 milion lekë, (v) Mbështetje financiare për studentët praktikantë dhe personelin akademik për të studiuar jashtë vendit, mbështetje për sportin dhe aktivitetet rinore, duke e bërë Shqipërinë tashmë pjesëmarrëse me titull të plotë në programin Erasmus+, që synon të nxitë modernizimin e sistemeve arsimore, si dhe (vi) Mbështetja financiare për pjesëmarrjen në marrëveshjen kuadër “Horizon 2020”, Programi i BE-së për Kërkim dhe Inovacion, si dhe programi Eurostudent janë parashikuar nga 100 -140 milion lekë në vit.

Për sportin dhe rininë për periudhën 2019-2021 parashikohet:

Fondet e planifikuara në programin e sportit dhe rinisë për periudhën 2019- 2021 janë në shumën 1.8 miliard lekë nga të cilat, për vitin 2019 janë parashikuar 600 milion lekë, për vitin 2020 janë 650 milion lekë dhe për vitin 2021 janë parashikuar 670 milion lekë. Për periudhën 2019-2021 sigurohet mbështetja financiare ndihmë shtetërore grant për 130-150 milionë lekë në vit, për rreth 25 federatave sportive, shpërblimin e sportistëve me rezultate kombëtare dhe ndërkombëtare, shpërblime dhe çmime për sportistët elitare 30-40 milion lekë në vit. Financimin e agjencisë dhe aktiviteve rinore 40-50 milion lekë në vit.

Për periudhën 2019-2021, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë do të financojë me prioritet:

- ✓ Rritja e numrit të sportistëve të licensuar në federata shqiptare të sportit, nga 20384 në vitin 2018, në 21 000 në vitin 2021.
- ✓ Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në programin e praktikave të punës nga 600 në vitin 2019, në 900 të rinj në vitin 2021.
- ✓ Sigurimi i mbështetjes financiare për 25 federata Olimpike dhe joolimpike në aktivitete Evropiane, Botërore dhe Ballkanike me synim kualifikim për lojërat Olimpike Japoni 2020.
- ✓ 20-25 Sportistë elitare të mbështetur financiarisht për rezultate të larta në aktivitete ndërkombëtare. (medalje e fituara);
- ✓ Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete me karakter social-kulturor dhe edukativ përmes rindërtimit dhe përmirësimit të infrastrukturës së 3 qendrave rinore rajonale.

Buxheti për MK 2019

Projektbuxheti i vitit 2019 krahasuar me projektbuxhetin e vitit 2018 ka një rritje prej 156 milion lekë, nga të cilat 55 milion lekë në investime dhe në korente, 101 milion lekë.

Rritje më e madhe është në programin e Art & Kulturë. Në fushën e trashëgimisë kulturore prioritet për shpenzimet korrente do të jenë mirëmbajtja e monumenteve të kulturës sipas listës së emergjencës të gjendjes fizike të tyre, Parqeve Arkeologjike dhe Muzeve Kombëtare, si dhe për të përballuar detyrimet për ruajtjen e objekteve apo çdo detyrim tjetër që lidhet me to. Përmirësimi gjithnjë e në rritje i të ardhurave nga turizmi kulturor në fushën e trashëgimisë kulturore ka rritur ndjeshëm numrin e vizitorëve vendas e të huaj.

Në fushën e artit dhe kulturës, në prioritetet e vitit 2019-2021 vëmëndje e posaçme do i kushtohet rikualifikimit dhe rikonceptim të Institucioneve Qendrore të Artit dhe Kulturës. Vijimi i një reforme tashmë të nisur në institucionet e artit përmes Programit Kombëtar “Edukimi përmes Kulturës”, do të rrisë efikasitetin e edukimit përmes librit, veprimtarive të artit skenik, përfshirë dhe teatrin eksperimental, nxitjen e artistëve të rinj, organizimit të ekspozitave kombëtare dhe ndërkombëtare të arteve pamore, kinematografisë etj. Edukimi masiv me art e kulturë do të synojë ndërhyrjen në kurrikulat shkollore nga njëra anë, si dhe përfshirjen nga ana tjetër, në çdo institucion arti të linjën pedagogjike dhe edukative. Do të vihet në zbatim Strategjia Kombëtare e Kulturës “Shqipëria 2018-2025”, përmes së cilës synohet që arti dhe kultura duhet të bëhen tërheqës për biznesin dhe financuesit e tjerë jo publikë përmes lehtësirave ligjore dhe fiskale.

IV. KONSULTIMI PUBLIK I PROJEKLTIGJIT

Komisioni, mbështetur në nenin 36, pika 1 dhe nenin 80, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, në kuadër të gjithëpërfshirjes, transparencës dhe konsultimit publik, gjatë shqyrtimit nen për nen dhe në tërësi të projektligjit, në dy seanca të veçanta, ka realizuar seanca dëgjimore me aktorë të interesit dhe shoqërinë civile, si: Shoqata e Botuesve Shqiptarë (për TVSh e librit dhe honoraret); Koalicioni për Arsimin në Shqipëri – ACE ; MEDPAK - Shoqata e prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuar; Organizata Ballkan-Egjiptiane e Shqipërisë; Shoqata e Prindërve të femijëve me aftësi ndryshe; Down Syndrome Albania Foundation; Qendra “Për arsimin cilësor”;

Aktorët e interesit dhe shoqëria civile gjatë diskutimeve propozuan:

Të pasurohen bibliotekat publike ekzistuese, duke filluar me ato shkolloret; të korrigojohet anomalia e TVSH mbi librin, prej janarit 2006 është 20% në blerje dhe 0 në shitje. Ky tatim duhet të jetë i barabartë në të dy kahet, pra i rimbursueshëm; të aplikohet një TVSH më e ulët, siç është kudo në Europë (luhatet midis 4-6%); tatimi mbi honoraret e krijimtarisë të jetë në nivelin 5-10%;

të rritet financimi i arsimit parauniversitar; të përcaktohet mësuesi ndihmës si një produkt më vete në PBA 2019-2021 dhe të rritet e numri i tyre brenda vitit 2018; Numri i psikologëve dhe punonjësve socialë duhet të shtohet gradualisht, pasi raporti për nxënës e bën krejtësisht të pamundur ofrimin efektiv të këtij shërbimi; të ketë ofrim të shërbimeve cilësore riaftësuese për fëmijët me Aftësi të Kufizuara; shërbimi riaftësues i ofruar nga institucionet publike ose ato me financim publik rezultojnë i pamjaftueshëm apo mungon tërësisht në shumë prej bashkive të vendit; kërkohet mbështetje e qendrës që ofron shërbime të ndërhyrjes së hershme. Rritja e numrit të nxënësve me aftësi të kufizuara, që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, nga 90 nxënës në vitin 2018 në 120 nxënës në vitin 2021". Për këtë objektiv kërkohet zë buxhetor për përshtatje të kurrikulave në arsimin profesional dhe buxhet për teknologji; për arsimin profesional të shikohet me prioritet t'i kalojë MASR; të rriten fondet për implementimin e aktiviteteve të Shkollave Qendër Komunitare; buxheti të financojë trajnimin e mësuesve për çështje kryesore të legjislacionit të lidhura me të drejtat e njeriut, sidomos me të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen nga diskriminimi; të ketë ushqim falas për fëmijët që jetojnë në varfëri absolute; të ketë rritje me 50% të kuotave për studime pasuniversitare të egjiptianëve; të ngrihet nje sektor i veçantë për punësimin e komuniteteve egjiptian, së paku një egjiptian të punësohet te privati etj.

V. REKOMANDIMET

Për nenin 1 të projektligjit “Për Buxhetin e Vitit 2018” u bënë këto propozime nga mazhoranca:

1. RTSH t'i jepet shtesë në investime **490 milion** nga 540 milion lekë të kërkuara nga RTSH.milionë lekë;
2. Komisioni mbështet kërkesën **13 milion lekë** për organizimin e “FESTIVALI I 14-të KOMBËTAR I FILMIT SHQIPTAR”.
3. Akademia e Shkencave në zërin investime të mbështetet me **1,000 lekë**
4. Akademia e Studimeve Albanologjike të ketë rritje për investimet.
5. Komisioni mbështet kërkesën e ATSH-së për paga dhe investime me **5,000 lekë**
6. Sporti ne ligjin e llotorive sportive fitonte 0.4 % te fitimit ne muaj nga kompanitë e basteve. Meqenëse me ligj këtë kompani u mbyllën kërkohet kjo shumë të kompensohet me **25 milionë lekë** për vitin 2019.

7. Të mbështetet arsimi dhe formimi profesional për industrinë nxërrnxerrëse dhe përpunuese në zonën më naftëmbajtëse të vendit (Mallakstër). E rendësishme do të ishte të kishte një shkollë politeknike me këtë profil.
8. Të rishikohet në akte nënligjore tarifa e transportit të nxënësve me banim mbi 2(dy) km dhe mësuesve me banim mbi 5(pesë)km nga qendra e shkollës.

Bashkëlidhur tabela e propozimeve përkatëse të miratuara në Komision.

Institucioni	Plani 000/lek	Zëri buxhetor	Kërkesa shtesë 000/lek	Miratimi i KEMIP
MASR	39,167,143		0	PO
MK	2,165,867		0	PO
AP	3,319			PO
ASH	110,000	investime	2,000	1,000
ASA	190,114		122,000	Përmirësime ligjore dhe kujdes në rritje për investimet
RTSH	615,000	investime	540,000	490,000
QKK	169,120	Korrente/festival	27,000	13,000
ATSH	69,000	Paga/Investime	6,000	5,000
SPORTI			25.000.000	25.000.000

Për nenin 16 Komisioni propozoi:

Në nenin nenin 16, te transferta e pakushtezuar sektoriale në anekset 1 dhe 4 të shtohet një paragraf, për transferten shtesë të Bashkisë Tiranë.

Fondi prej 32 milion lekë dhe numri prej 26 punonjës për klubet “Studenti” dhe “Partizani” është aktualisht brenda buxhetit të MASR për vitin 2019. Për të realizuar kalimin e këtyre dy klubeve do të duhet që të pakësohet fondi prej 32 milionë lekë te programi i sportit dhe nr. punonjësve prej 26 vetë nga MASR të shtohet fondi në Transferten specifike të Bashkisë Tiranë.

Për nenin 23 Komisioni propozoi:

Neni 23 riformulohet si vijon: “ Ky ligj hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet financiare nga data 1 janar 2019”

Komisioni në përfundim miratoi me shumicë votash, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2019”, propozim i Këshillit të Ministrave.

RELATORË

Vilma BELLO

Ismet BEQIRAJ

ZV/KRYETARE

RELATORE

Milva EKONOMI